

4) воспитувач за престој на деца на возраст од шест години, односно од поаѓање во основно училиште до десет години возраст може да биде лице кое ги исполнува условите за воспитувач, а може да биде и лице со завршени студии за одделенска настава со стекнати 240 кредити според ЕКТС или завршено високо образование VII/1 степен и важечка лиценца за воспитувач;

5) неговател може да биде лице со завршено средно четиригодишно образование и важечка лиценца за неговател;

6) стручни соработници може да бидат музички педагог, дипломиран ликовен педагог, дипломиран педагог по физичко воспитание, дипломиран професор по странски јазик и книжевност - со стекнати 240 кредити според ЕКТС или завршен VII/1 степен и важечка лиценца за стручен соработник, виша медицинска сестра, дипломирана општа медицинска сестра/медицински техничар, дипломирана медицинска сестра/медицински техничар - со стекнати 180 кредити според ЕКТС или завршен VI/1 степен и важечка лиценца за стручен соработник и социјален работник и логопед - со стекнати 180 кредити според ЕКТС или завршен VI/1 степен и важечка лиценца за стручен соработник;

7) нега и грижа со децата со специфични потреби попречени во менталниот развој или телесна попреченост, можат да вршат и помошници - воспитувачи со четиригодишно средно образование или со вишо образование кои поседуваат важечка лиценца за неговател и

8) стручно административно-технички работи можат да вршат и други вработени согласно со потребите на приватна детска градинка/центар за ран детски развој.

(2) Стручните и административните работи во приватно детско одморалиште во зависност од видот на работите ги вршат вработени со високо образование VII /1 или со стекнати 240 кредити според ЕКТС, со вишо или средно четиригодишно образование.

(3) Готварските и техничките работи во приватна установа за деца може да ги вршат вработени со завршен соодветен степен на стручна подготовка.

(4) Видот и степенот на стручната подготовка за вработените во приватните установи за деца се утврдуваат со актот за внатрешна организација и систематизација на работните места во установата.“

Член 21

Подзаконските акти предвидени со овој закон, министерот ќе ги донесе во рок од девет месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 22

Статутот на јавната установа ќе се усогласи со одредбите од овој закон во рок од девет месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 23

Директорот на јавна установа за деца, избран, односно именуван до денот на започнувањето на примената на членот 1 од овој закон, продолжува да ја врши функцијата до истекот на мандатот за кој е избран, односно именуван.

Член 24

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецистен текст на Законот за заштита на децата.

Член 25

Одредбите од членот 1 од овој закон ќе започнат да се применуваат една година од денот на влегувањето во сила на овој закон, освен одредбите кои се однесуваат на условот за познавање на странски јазик кои ќе започнат да се применуваат по пет години од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 26

Одредбите од членовите 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 и 20 ќе започнат да се применуваат со денот на започнувањето со примената на Законот за вработените во јавниот сектор („Службен весник на Република Македонија“ број 27/14) и Законот за административните службеници („Службен весник на Република Македонија“ број 27/14).

Член 27

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 23/13 dhe 12/14), në nenin 120 në paragrafin (2) fjalët: “neni 134” zëvendësohen me fjalët: “neni 136”, fjalët: “mbi katër vite” zëvendësohen me fjalët: “minimum pesë vite”, pas fjalëve: “pas diplomimit” vihet presje dhe shtohen fjalët: “posedon certifikatë ose dëshmi jo më të vjetër se pesë vite të njohur ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze: TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) Cambridge English: Legal) - së paku A2 (A2) nivelin, FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë, BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose APTIS (APTIS) – së paku niveli A2 (A2), të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet”.

Në paragrafin (3) fjalët: “mbi katër vite” zëvendësohen me fjalët: “minimum pesë vite”, pas fjalëve: “pas diplomimit” vihet presje dhe shtohen fjalët: “posedon certifikatë ose dëshmi jo më të vjetër se pesë vite të njohur ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze: TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) Cambridge English: Legal) - së paku niveli A2 (A2), FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë, BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose APTIS (APTIS) – së paku niveli A2 (A2), të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet”.

Në paragrafin (11) pas fjalëve: “katër vite” pika shlyhet dhe shtohen fjalët: “pas shpalljes publike të zbatuar për zgjedhje, përkatësisht emërim të publikuar në tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetata që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. “

Neni 2

Kreu XI ndryshohet si vijon: “TË PUNËSUARIT NË INSTITUCIONE PUBLIKE PËR PËRKUJDESJE DHE EDUKIM TË FËMIJËVE TË MOSHËS PARASHKOLLORE DHE NË INSTITUCIONET PUBLIKE PËR PUSHIM DHE REKREACION TË FËMIJËVE”

Neni 3

Neni 134 ndryshohet si vijon:

“(1) Në institucionet publike për fëmijë vendet e punës së të punësuarve grupohen në grupe dhe nëngrupe në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik:

- nëpunës administrativë,
- dhënëse të shërbimeve publik në institucionet publike për fëmijë dhe
- persona ndihmës-teknikë.

(2) Të punësuarit në Agjencinë të cilët kryejnë punë administrative të natyrës administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

(3) Për të punësuarit nga paragrafi (2) të këtij neni kategoritë, nivelet dhe titujt përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunësit administrativë.

(4) Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin, avancimin, përsosjen profesionale dhe aftësimin, matjen e kontributit dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës së nëpunësve administrativ në institucionet publike për fëmijë zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit administrativë.

(5) Të punësuarit në institucionet publike për fëmijës, të cilët kryejnë punë teknike dhe ndihmëse kanë status të personelit ndihmës-teknik.

(6) Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit ndihmës-teknik në institucionet publike për fëmijë, zbatohen dispozitat e Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës.”

Neni 4

Neni 135 ndryshohet si vijon:

“(1) Të punësuarit në institucionet publike për fëmijë të cilët kryejnë punë edukativo-akomoduese, punë edukativo-arsimore, punë pedagogjike dhe psikologjike, punë të mbrojtjes sociale, punë të mbrojtjes preventive shëndetësore, punë profesionale për mbrojtjen e fëmijëve, punë profesionale për pushim dhe rekreacion të fëmijëve dhe punë tjera profesionale për mbrojtjen e fëmijëve.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen kategoritë e vendeve të punës në vijim:

- Kategoria A – punëtorë profesionalë,
- Kategoria B – bashkëpunëtorë profesionalë,
- Kategoria B – edukatorë,
- Kategoria G – përkujdesës dhe
- Kategoria D – përkujdesës/asistent – edukator”

Neni 5

Neni 136 ndryshohet si vijon:

“(1) Në suazat e kategorisë A caktohet niveli në vijim i vendeve të punës së punëtorëve profesionalë:

- niveli A1 punëtorë profesionalë të nivelit të parë (pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë dhe doktor i stomatologjisë - me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 dhe licencë të vlefshme për punëtor profesional).

(2) Në suazat e kategorisë B përcaktohen nivelet në vijim të vendeve të punës së bashkëpunëtorëve profesionalë:

- niveli B1 bashkëpunëtorë profesionalë të nivelit të parë (pedagog i muzikës, pedagog i diplomuar i artit figurativ, pedagog i diplomuar i edukatës fizike, profesor i

diplomuar për gjuhë të huaj dhe letërsi – me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional; infermiere e lartë, infermiere e përgjithshme e diplomuar/teknik mjekësor, infermiere e diplomuar/teknik mjekësor – me 180 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VI/1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional; punëtor social dhe logoped – me 180 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VI/1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional.

(3) Në suazat e kategorisë B përcaktohen nivelet në vijim të vendeve të punës së edukatorëve:

- niveli B1: edukator i nivelit të parë i cili mund të jetë:

1) Edukatorë të fëmijëve mbi moshën dy vjeçare deri në gjashtë vjet, përkatësisht deri në shkuarje në shkollë fillore: profesor i diplomuar për arsim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve në moshën parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukatë parashkollore – me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të mbaruar të lartë të shkallës VII/1 ose me arsim përkatës të lartë të mbaruar për edukatorë dhe licencë të vlefshme për edukator.

2) Edukator në grup me fëmijë me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa fizike mund të jetë: defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues me 240 kredi të fituara sipas SETK ose studime përkatëse të mbaruara për punë me fëmijë me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa fizike – shkallë VII/1 dhe licencë të vlefshme për edukator si dhe personi i cili i plotëson kushtet për edukator nga paragrafi (4) pika 2 të këtij neni dhe

3) Edukator për qëndrim të fëmijëve në moshën gjashtë vjeçare, përkatësisht nga shkuarja në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjeçe, mund të jetë personi i cili i plotëson kushtet për edukator nga pika 2 të paragrafit (3) të këtij neni, kurse mund të jetë edhe personi me studime të mbaruara për mësim klasor shkalla VII/1 ose me 240 kredi të fituara sipas SETK dhe licencë të vlefshme për edukator.

(4) Në suazat e kategorisë G përcaktohen nivelet në vijim të vendeve të punës së përkujdesësve:

- niveli G1 përkujdesës i nivelit të parë (arsim të mbaruar të mesëm katërvjeçar dhe licencë të vlefshme për përkujdesës).

(5) Në suazat e kategorisë D përcaktohen nivelet në vijim të vendeve të punës së përkujdesësve:

- niveli D1 përkujdesës/ndihmës – edukator për përkujdesje dhe kujdes të fëmijëve me nevoja specifike me pengesa në zhvillimin mental ose pengesë fizike të nivelit të parë (arsim të mbaruar katërvjeçar të mesëm ose me arsim të lartë që posedon licencë të vlefshme për përkujdesës)."

Neni 6

Nenet 137, 138, 139, 140 dhe 141 shlyhen.

Neni 7

Në nenin 142 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“I punësuarit në institucion për fëmijë duhet ti plotësojë edhe këto kushte të përgjithshme:"

Në alinën 4, pas fjalës “dënim” shtohen fjalët: “ose sanksion kundërvajtës”.

Neni 8

Pas nenit 142 shtohet nen i ri 142 - a, si vijon:

“Neni 142-a

Drejtori i institucionit publik për fëmijë, përgatit plan vjetor për punësim të dhënësve të shërbimeve publike, nëpunësve administrativë dhe personave ndihmës teknikë në institucionin publik për fëmijë për vitin e ardhshëm, në pajtim me Ligjin për të punësuar në sektorin publik.

Neni 9

Neni 143 ndryshon si vijon:

“(1) Për plotësimin e vendit të lirë të punës për kryerjen e punëve nga interesi publik në institucionet publike për fëmijë, drejtori i institucionit merr vendim për nevojë të punësimit të punëtorëve.

(2) Me vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet nëse plotësimi i vendit të lirë të punës në institucion kryhet përmes punësimit të personit nëpërmjet publikimit të shpalljes publike, publikimit të shpalljes së brendshme, sistemimit nga të punësuarit në institucion ose me marrjen e punëtorit nga institucion tjetër.

(3) Drejtori i institucionit publik për fëmijë nevojën për punëtorë e siguron përmes:

1) publikimit të shpalljes publike në gazetën ditore në barrë të punëdhënësit dhe

2) shpalljes në shërbimin kompetent për ndërmjetësim gjatë punësimit, pa pagesë, në pajtim me ligjin.

(4) Në institucionin publik për fëmijë, gjatë punësimit zbatohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve të cilët u takojnë të gjithë bashkësive në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht në njësitë e vetadministrimit lokal, pa mos u prishur kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës.

(5) Në institucionin publik për fëmijë, nevoja për punëtor sigurohet me publikimin e shpalljes publike në së paku në dy gazeta ditore nga të cilat së paku në njërin nga gazetata që botohet në gjuhën maqedonase dhe në gazetata që botohen në gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(6) Me përjashtim, drejtori nga paragrafi (4) i këtij neni, për punë urgjente dhe të paprolongueshme, marrëdhënie të punës mund të themelojë edhe pa shpalle publike, por më së shumti deri në 30 ditë, me ndërmjetësimin e shërbimit kompetent për ndërmjetësim gjatë punësimit.

(7) Me përjashtim nga paragrafi (3) pika 1 të këtij neni, për kryerjen e punës sezonale mund të themelohet marrëdhënie e punës edhe pa shpallje publike, por më së shumti deri në 90 ditë, me ndërmjetësimin e shërbimit kompetent për ndërmjetësim gjatë punësimit.

(8) Punëtori i cili ka arsim përkatës, përvojë pune të nevojshme në profesion dhe i plotëson edhe kushtet tjera të përcaktuara në aktin për organizim të brendshëm dhe sistemim të vendeve të punës të institucionit, sipas nevojës së institucionit ose me kërkesë të tij, mund të sistemohet në vend tjetër të punës në pajtim me aktin për organizim të brendshëm dhe sistemim të vendeve të punës ose të merret në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni i cili kryhet pa shpallje me marrëveshje për marrje të punëtorit nga një institucion publik në institucion tjetër për fëmijë si dhe me marrëveshje për marrjen e punëtorit nga/në institucion tjetër publik ose ent nëse për atë ka pëlqim të personave udhëheqës të institucioneve dhe punëtorit.

(9) Në rastet kur plotësimi i vendit të lirë të punës kryhet nëpërmjet publikimit të shpalljes interne, që publikohet në ueb faqen dhe në tabelën e shpalljeve të

institucionit. Shpallja përmban të dhëna për vendin e punës i cili duhet të plotësohet dhe për kushtet e nevojshme të cilat duhet t'i plotësojë kandidatit për punësim në pajtim me këtë ligj dhe aktin për organizim të brendshëm dhe sistemim të vendeve të punës të institucionit, kurse afati për publikim të shpalljes interne nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë pune nga dita e publikimit të saj.

(10) Kur drejtori punëson punëtor nëpërmjet shpalljes publike, është i detyruar në shpalljen publike t'i theksojë kushtet të cilat kërkohen për kryerjen e punës, afatin për paraqitje, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë pune dhe afatin në të cilin drejtori pas skadimit të afatit për paraqitje do të kryejë zgjedhje.

(11) Nëse në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni janë paraqitur deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja bëhet në afat prej 45 ditësh, nga 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja bëhet në afat prej 90 ditësh dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja bëhet në afat prej 120 ditësh, pas skadimit të afatit të paraqitjes.

(12) Për kohëzgjatjen e shpalljes publike, drejtori nuk mund të publikojë shpallje të re për vendin e njëjtë të punës.

(13) Shpallja publike përfundon me zgjedhje, moszgjedhje ose me skadimin e afatit nga paragrafi (3) dhe(4) të këtij neni.

(14) Në shpalljen publike përveç kushteve tjera të posaçme, drejtori është i detyruar ta theksojë fillimin dhe përfundimin e kohës së punës ditore dhe javore, orarin e kohës të punës dhe shumën në para të rrogës themelore për vendin e punës për të cilin kërkohet punëtor.

(15) Nëse për vendin e caktuar të punës kërkohet punëtor me autorizime të posaçme, në shpalljen publike duhet të theksohet se vendi i punës është me autorizime të posaçme.

(16) Për publikim llogaritet, gjithashtu, dhe publikimi në hapësirat e shërbimit kompetent për ndërmjetësim gjatë punësimit.

(17) Nëse drejtori e shpall vendin e lirë të punës edhe në mjetet për informim publik, afati për paraqitje fillon të zgjasë nga dita e shpalljes së fundit.

Neni 10

Neni 144 shlyhet.

Neni 11

Neni 148 ndryshon si vijon:

“Dhënësit të shërbimit publik, nëpunësit administrativ dhe personit ndihmës-teknik, për shkak të shkeljes së rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësimin të detyrimeve të përcaktuara me ligj, marrëveshje kolektive, akt të punëdhënësit dhe marrëveshje për punësim mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës ose varësisht nga shkalla e përgjegjësisë së punëtorit, kushtet në të cilat është bërë shkelja të detyrave të punës dhe të rendit të punës dhe disiplinës, puna e mëhershme dhe sjellja e punëtorit, pesha e shkeljes dhe pasojat e saj, punëdhënësi mund që punëtorit t'i shqiptojë dënim me para në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.”

Neni 12

Nenet 149, 150, 151, 152, 153, 154 dhe 155 shlyhen.

Neni 13

Neni 156 ndryshohet si vijon:

“(1) Punëtori i cili në punë ose në lidhje me punën me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme i shkakton dëm institucionit publik për fëmijë është i detyruar ta kompensojë atë.

(2) Nëse më shumë punëtorë shkaktajnë dëm secili mes tyre është përgjegjës për atë pjesë të dëmit që e ka shkaktuar.

(3) Nëse për secilin punëtor nuk është e mundur të përcaktohet çfarë pjesë të dëmit ka shkaktuar, të gjithë punëtorët janë me përgjegjësi të njëjtë dhe e kompensojnë dëmin në pjesë të barabarta.

(4) Nëse shumica e punëtorëve kanë shkaktuar dëm me veprim të qëllimtë të ndëshkueshëm, për dëmin janë përgjegjës në mënyrë solidarie.

(5) Nëse punëtori në punë ose në lidhje me punën me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme i shkaktonte dëm personit të tretë, institucioni publik për fëmijë është i obliguar atij personi t'ia kompensojë dëmin, kurse punëtori është i detyruar t'ia kompensojë dëmin institucionit publik për fëmijë.

(6) Nëse përcaktimi i lartësisë së dëmit do të kishte shkaktuar shpenzime joporcionale, dëmshpërblimi mund të caktohet në shumë paushall, nëse rastet e veprimeve të dëmshme të punëtorit dhe lartësia e dëmshpërblimit paushal janë përcaktuar me marrëveshje kolektive.

(7) Me marrëveshje kolektive për punëtorin mund të caktohen mënyra dhe kushtet për zvogëlim ose falje të pagimit të dëmshpërblimit.

(8) Nëse punëtorit i është shkaktuar dëm gjatë punës ose në lidhje me punën, institucioni publik për fëmijë është i obliguar t'ia kompensojë dëmin, sipas rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë për kompensim të dëmit.

(9) Përgjegjësia për dëmshpërblim të institucionit publik për fëmijë, gjithashtu, ka të bëjë edhe me dëmin të cilin institucioni publik për fëmijë e ka shkaktuar me shkeljen e të drejtave të punëtorit nga marrëdhënia e punës.

Neni 14

Nenet 157 dhe 158 shlyhen.

Neni 15

Neni 159 ndryshohet si vijon:

“(1) Të punësuarit në institucion publik për fëmijë kanë të drejtë në përsosje profesionale, për çka drejtori miraton plan për zhvillim të vazhdueshëm profesional në pajtim me programin për edukim të vazhdueshëm të dhënësve profesionalë të shërbimeve profesionale nga neni 136 i këtij ligji.

(2) Institucionet publike për fëmijë themelojnë sistem për menaxhim me kontributin e dhënësve të shërbimeve publike nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Sistemin nga paragrafi (2) të këtij neni e përbëjnë: përcaktimi i qëllimeve dhe detyrave të punës, përcaktimi i planit individual për përsosje profesionale, si dhe procedura për vlerësim të kontributit të dhënësit profesional të shërbimit publik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Qëllimet dhe detyrat e punës së dhënësit të shërbimit publik nga paragrafi (1) i këtij neni në institucionin publik për fëmijë përcaktohen në bazë të programit vjetor për punë të institucionit publik për fëmijë.

(5) Qëllimet dhe detyrat e punës të dhënësve të shërbimeve publike nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jenë të qarta, të sakta, të matshme dhe me kornizë të caktuar kohore për realizim.

(6) Qëllimet dhe detyrat e punës përcaktohen nga ana e drejtorit të institucionit publik për fëmijë ose personit tjetër të autorizuar nga ai, në bashkëpunim me dhënësin profesional të shërbimit profesional, në muajin dhjetor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(7) Drejtori i institucionit publik për fëmijë ose personi i autorizuar nga ai, është i obliguar në vazhdimësi ta përcjellë kontributin e dhënësit profesional të shërbimit profesional nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë gjithë vitit dhe sipas nevojës të propozojë masa për përmirësimin e të njëjtit.

(8) Si pjesë e procesit të përcjelljes së vazhdueshme të kontributit të dhënësit profesional të shërbimit publik nga paragrafi (1) i këtij neni, më së shumti deri më 1 nëntor zbatohet intervistë vjetore për vitin rrjedhës.

(9) Pas zbatimit të intervistës vjetore plotësohet raporti për intervistë vjetore, të cilin e nënshkruajnë dhënësi profesional i shërbimit publik nga paragrafi (1) i këtij neni dhe drejtori i institucionit publik për fëmijë ose personi i autorizuar nga ai.

(10) Kopje nga raporti i paragrafit (9) të këtij neni i parashtrohet dhënësit profesional të shërbimit nga paragrafi (1) të këtij neni.

(11) Nëse në raportin për intervistën vjetore, drejtori i institucionit për fëmijë ose personi i autorizuar nga ai, konstaton se dhënësi profesional i shërbimit publik nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i ka plotësuar qëllimet e parashtuara përkatësisht jep rezultate të pamjaftueshme gjatë periudhës vjetore, nuk demonstroi kompetencë dhe profesionalizëm të nevojshëm, ka gabime të konsiderueshme në punë dhe veprim, detyrat e punës i kryen jo në kohë përkatësisht nuk tregon interes për cilësinë e realizimit të detyrave të punës, i njëjti do të fillojë procedurë për përmirësimin e kontributit.

(12) Në procedurën për përmirësim të kontributit propozohen trajnime shtesë ose mentori dhe kumtohet vërejtje me shkrim në të cilën dhënësi profesional i shërbimit publik paralajmërohet për mundësinë të vlerësohet me notë negative nëse krahas sugjerimeve dhe masave të propozuara, deri në skadimin e vitit të ardhshëm nga viti kur është bërë vlerësimi, nuk e përmirëson kontributin e vet.

(13) Mënyrën e zbatimit të intervistës vjetore dhe vlerësimit, si dhe formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi (9) i këtij neni dhe të formularit për vlerësim, i cakton ministri.”

Neni 16

Nenet 160, 161, 162, 163 dhe 164 shlyhen.

Neni 17

Neni 165 ndryshohet si vijon:

“(1) Dhënësit profesionalë të shërbimeve publike nga neni 136 të këtij ligji, në institucionet publike për fëmijë, detyrimisht vlerësohen një herë një vit, edhe atë më së voni deri më 1 dhjetor të vitit rrjedhës.

(2) Vlerësimin e dhënësve profesionalë të shërbimeve publike nga paragrafi (1) i këtij neni e bën drejtori i institucionit publik për fëmijë ose personi i autorizuar i tij (në tekstin e mëtejshëm: vlerësues).

(3) Vlerësuesi me nota prej 1 deri në 5 e vlerëson kualitetin, efektivitetin dhe efikasitetin e punës, respektimin e afateve dhe nivelin e plotësimit të qëllimeve të përcaktuara të punës dhe detyrave, nivelin e përfshirjes dhe përkushtimit në punë, kontributin në realizimin e programit për punë të institucionit publik për fëmijë, duke pasur parasysh raportin e intervistës vjetore.

(4) Pas përfundimit të vlerësimit, kopje e formularit për vlerësim, përveç pjesës e cila ka të bëjë me notat individuale të vlerësuesve tjerë, dorëzohet edhe tek dhënësit profesionalë të shërbimeve publike nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Kundër notës për rezultatin dhënësi profesional i shërbimit publik i pakënaqur nga paragrafi (1) i këtij neni ka të drejtë të paraqesë ankesë në Këshillin Drejtues të institucionit publik për fëmijë, në afat prej tetë ditëve pas pranimit të kopjes së formularit për vlerësim.

(6) Drejtori i institucionit publik për fëmijë, është i obliguar të përgatit dhe më së voni deri më 31 dhjetor, në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale të dorëzojë raport me ranglistën e notave vjetore për të gjithë dhënësit profesionalë të shërbimeve publike të vlerësuar paragrafi (1) i këtij neni në institucionin publik për fëmijë për vitin rrjedhës.

(7) Dhënësi profesional i shërbimeve publike paragrafi (1) i këtij neni i cili gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, ka munguar nga puna më gjatë se gjashtë muaj (pushim mjekësor, mungesë pa pagesë etj), si dhe dhënësi i shërbimit publik i cili për herë të parë është punësuar në institucionin publik për fëmijë dhe ka punuar më shkurt se gjashtë muaj në periudhën për të cilën kryhet vlerësimi, nuk do të vlerësohet.

(8) Vlerësimin e dhënësit profesional të shërbimit publik paragrafi (1) i këtij neni, i cili gjatë vitit për të cilin kryhet vlerësimi, janë sistemuar, përkatësisht marrë në vend tjetër të punës, e kryen vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak."

Neni 18

Neni 166 ndryshohet si vijon:

"(1) Nota vjetore e dhënësit profesional të shërbimit publik nga neni 136 të këtij ligji mund të jetë:

- "veçanërisht dallohet", nëse ka vlerë prej 4.51 deri 5.00,
- "dallohet", nëse ka vlerë prej 3.51 deri 4.50,
- "mjaftueshëm", nëse ka vlerë prej 2.51 deri 3.50,
- "pjesërisht mjaftueshëm", nëse ka vlerë prej 1.51 deri 2.50 dhe
- "pamjaftueshëm", nëse ka vlerë prej 1.00 deri 1.50.

(2) Dhënësit profesionalë të shërbimeve publike nga paragrafi (1) i këtij neni, për të cilët nota vjetore është "veçanërisht dallohet", do të shpërblehen me bonus në shumë prej së paku një rroge të pranuar në muajin e fundit në vitin në të cilin është bërë vlerësimi, përkatësisht në ditë të lira ose lloj tjetër të shpërblimit jo material.

(3) Dhënësit të shërbimit publik i cili është i vlerësuar me notë "pamjaftueshëm", do t'i zvogëlohet rroga më së shumti në shumë prej 30% në periudhë prej tre muaj. Nëse dhënësi i shërbimit profesional dy herë të njëpasnjëshme vlerësohet me notë "pamjaftueshëm" do t'i ndërpritet marrëdhënia e punës.

(4) Dhënësit të shërbimit publik i cili është i vlerësuar me notë "pjesërisht mjaftueshëm", do t'i zvogëlohet rroga më së shumti në shumë prej 15% në periudhë prej tre muajve.

(5) Nëse dhënësi profesional i shërbimit publik është i vlerësuar me notë "pjesërisht mjaftueshëm" në tre vlerësime të njëpasnjëshme, do t'i ndërpritet marrëdhënia e punës."

Neni 19

Pas neni 166 shtohet titull i ri si vijon: "XI-a. PERSONA PROFESIONALË PËR PËRKUJDESJE DHE EDUKIM TË FËMIJËVE TË MOSHËS PARASHKOLLORE DHE PËR PUSHIM DHE REKREACION TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONE PRIVATE PËR FËMIJË".

Neni 20

Neni 167 ndryshohet si vijon:

"(1) Punët profesionale në veprimtarinë përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore në kopshtet private fëmijërore/qendra për zhvillim të hershëm fëmijëror i kryejnë personat profesionalë në vijim:

- punëtor profesionalë (pedagog, psikolog, punëtor social, defektolog/edukator special dhe rehabilitues, logoped, doktor i mjekësisë dhe doktor i stomatologjisë),
- edukator,
- përkujdesës dhe
- bashkëpunëtorë profesionalë (pedagog i muzikës, pedagog i artit figurativ, pedagog i edukatës fizike, profesor i gjuhës së huaj dhe letërsisë, infermiere e lartë dhe punëtor social).

1) Punëtorë profesionalë mund të jenë pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë dhe doktor i stomatologjisë - me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 dhe licencë të vlefshme për punëtor profesional;

2) Edukatorë mund të jenë profesor i diplomuar për arsim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukatë parashkollore-me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të mbaruar të lartë shkallën VII/1 ose me arsim përkatës të lartë të mbaruar për edukatorë dhe licencë të vlefshme për edukator;

3) Edukator në grup me fëmijë me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa fizike mund të jetë: defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues me 240 kredi të fituara sipas SETK ose studime përkatëse të mbaruara për punë me fëmijë me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa fizike - VII/1 dhe licencë të vlefshme për edukator si dhe personi i cili i plotëson kushtet për edukator nga paragrafi (3) e këtij neni;

4) Edukator për qëndrim të fëmijëve të moshës prej gjashtë vjet, përkatësisht nga shkuarja në shkollë fillore deri në moshën dhjete vjeçare mund të jetë personi i cili i plotëson kushtet për edukator, kurse mund të jetë edhe personi me studime të mbaruara për mësim klasor me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të mbaruar të lartë shkallë VII/1 dhe licencë të vlefshme për edukator;

5) Përkujdesës mund të jetë personi me arsim të mesëm katërvjeçar të mbaruar dhe licencë të vlefshme për përkujdesës;

6) Bashkëpunëtorë profesionalë mund të jenë pedagog i muzikës, pedagog i diplomuar i artit figurativ, pedagog i diplomuar i edukatës fizike, profesor i diplomuar për gjuhë të huaj dhe letërsi – me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional; infermiere e lartë, infermiere e përgjithshme e diplomuar/teknik mjekësor, infermiere e diplomuar/teknik mjekësor – me 180 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VI/1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional; punëtor social dhe logoped – me 180 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të mbaruar VI/1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional;

7) Përkujdesje dhe kujdes me fëmijët me nevoja të veçanta me pengesa në zhvillimin mentar ose pengesa fizike, mund të kryejnë edhe edukatorët-ndihmës me arsim të mesëm katërvjeçar ose me arsim të lartë të cilët posedojnë licencë të vlefshme për përkujdesës;

8) Punët profesionale administrativo-teknike mund t'i kryejnë edhe të punësuar tjerë në pajtim me nevojat e kopshtit privat për fëmijë/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve.

(2) Punët profesionale dhe administrative në pushimorin private fëmijërore varësisht nga lloji i punëve i kryejnë të punësuarit me arsim të lartë VII/1 ose me 240 kredi të fituara sipas SETK, me arsim të lartë ose arsim të mesëm katërvjeçar.

(3) Punët e gatimit dhe teknike në institucion privat për fëmijë mund t'i kryejnë të punësuarit me shkallë përkatëse të mbaruar të përgatitjes profesionale.

(4) Lloji dhe shkalla e përgatitjes profesionale për të punësuarit në institucionet private për fëmijë caktohen me aktin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në institucionin."

Neni 21

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, ministri do t'i miratojë në afat prej nëntë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 22

Statuti i institucionit publik do të harmonizohet me dispozitat e këtij ligji në afat prej nëntë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 23

Drejtori i Institucionit Publik për fëmijë, i zgjedhur, përkatësisht i emëruar deri në ditën e fillimit të aplikimit të nenit 1 të këtij ligji, vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur, përkatësisht emëruar.

Neni 24

Autorizohet Komisioni Juridiko-ligjvënës në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve.

Neni 25

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë të zbatohen pas pesë viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 26

Dispozitat nga nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 do të fillojnë të zbatohen me ditën e fillimit të aplikimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

1305.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ФИЛМСКАТА ДЕЈНОСТ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за филмската дејност, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 28 февруари 2014 година.

Бр. 07- 1316/1
28 февруари 2014 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

З А К О Н

ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ФИЛМСКАТА ДЕЈНОСТ

Член 1

Во Законот за филмската дејност („Службен весник на Република Македонија“ бр. 82/13 и 18/14), во членот 15 по ставот (2) се додава нов став (3), кој гласи:

„(3) За именување на директор се објавува јавен оглас во три дневни весници кои се издаваат на целата територија на Република Македонија од кои еден од весниците што се издаваат на јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните кои зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик.“

Ставот (3) станува став (4).

Ставот (4) кој станува став (5) се менува и гласи:

„(5) За директор може да биде именувано лице кое ги исполнува следниве услови:

1) е државјанин на Република Македонија;

2) во моментот на именувањето со правосилна судска пресуда не му е изречена казна или прекршочна санкција забрана за вршење на професија, дејност или должност;

3) има стекнати најмалку 240 кредити според ЕКТС или завршен VII/1 степен од областа на филмот или на општествените науки или правен факултет со положен правосуден испит или економски факултет;

4) има минимум пет години работно искуство во областа на филмот или правото или економијата;

5) поседува еден од следниве меѓународно признати сертификати или уверенија за активно познавање на англискиот јазик не постар од пет години:

- ТОЕФЕЛ ИБТ - најмалку 74 бода,

- ИЕЛТС (IELTS) - најмалку 6 бода,

- ИЛЕЦ (ILEC) (Cambridge English: Legal) - најмалку Б2 (B2) ниво,

- ФЦЕ (FCE) (Cambridge English: First) - положен,

- БУЛАТС (BULATS) - најмалку 60 бода или

- АПТИС (APTIS) - најмалку ниво Б2 (B2) и

6) има положено психолошки тест и тест за интегритет.“